



Njoftim Shtypi No. 07/261
PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME
15 Nëntor 2007

Fondi Monetar Ndërkombëtar
Uashington, D.C. 20431 SHBA

Deklaratë zyrtare e një stafi të misionit të FMN-së në Shqipëri

Një mision i FMN-së i kryesuar nga Z. Gewin Bell vizitoi Tiranën nga data 31 Tetor–14 Nëntor, për të diskutuar me autoritetet Shqiptare rishikimin e katërt nën programin e mbështetur nga FMN dhe ndikimin fiskal, financiar dhe makroekonomik të krizës aktuale energjitike. Misioni u takua me Kryeministrin Sali Berisha, Ministrin Ridvan Bode, Guvernatorin Ardian Fullani dhe zyrtarë të tjerë të lartë si edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar dhe dha deklaratën e mëposhtme:

“FMN do të vazhdojë të mbështesë rritjen e qëndrueshme ekonomike të Shqipërisë. Duke parë përpara, sfida kryesore për autoritetet shqiptare mbetet përcaktimi i një drejtimi të qartë mes shumë prioritetëve konkurruese për ekonominë shqiptare.

“Zhvillimi ekonomik mbetet i lartë në nivelin 6 përqind, pavarësisht krizës energjitike dhe thatësisë rajonale, por presionet nga kostoja e prodhimit i janë shtuar inflacionit dhe rreziqet fiskale po shfaqen në horizont. Eksportet më të mira se ç’ishin parashikuar dhe aktiviteti prodhues kanë kompensuar ndikimin negativ të krizës energjitike dhe të thatësisë mbi rritjen ekonomike. Gjithashtu, perspektiva e zhvillimit vazhdon të jetë pozitive, por nëse dëshirojmë të mbajmë progresin e mirë të këtyre viteve të fundit me të njëjtin ritëm, duhet të zgjidhen urgjentisht dhe me çdo kusht sfidat serioze makroekonomike. Veçanërisht, përkeqësimi drastik i situatës financiare të kompanisë shtetërore KESH duhet të ndryshojë drejtim dhe shpenzimet kapitale publike duhet të limitohen për të mënjeluar presionet inflacioniste. Nëse arrihen këto kritere, rritja e fundit e inflacionit është shumë e mundur të jetë e përkohshme, duke reflektuar kryesisht ndikimet e njëhershme të çmimeve të larta të ushqimeve dhe ndërprerjet e energjisë elektrike, zbatimi në kohë i politikës monetare dhe kredibiliteti që tashmë ka fituar Banka e Shqipërisë duhet të ndihmojë në uljen e inflacionit drejt nivelit të synuar.

“Duhet të ndërmerren masa të menjëhershme për të stabilizuar situatën financiare të KESH-it, ndërkohë që privatizimi është imperativ për të vendosur sektorin e energjisë në një bazë të qëndrueshme afatgjatë. Defiçiti i madh i KESH-it reflekton jo vetëm thatësisën, por kryesisht problemet kronike me humbjet në rrjet dhe arkëtimet, nivelet e papërballueshme të importit, si edhe çmimet e energjisë së importuar shumë herë më të larta sesa çmimi vendas. Megjithëse niveli i humbjeve në rrjet dhe arkëtimeve po përmirësohen, duke përjashtuar arkëtimet nga ndërmarrjet e ujë-sjellësave, do të nevojiten përpjekje akoma më të mëdha për të zgjidhur këto probleme thelbësore. Privatizimi i KESH-it është i domosdoshëm të bëhet vitin që vjen, por kjo kërkon një bashkëpunim të ngushtë mes autoriteteve Shqiptare, Bankës Botërore, KFN (Korporata Financiare Ndërkombëtare) si edhe të tjerë partnerë zhvillues të rëndësishëm, në mënyrë që të gjitha kriteret—përfshirë dhe krijimin e domosdoshëm të një

enti rregullator dhe strukturat e tregut—të arrihen në harmoni. Kushtëzuar nga realizimi i këtyre masave, furnizimi i pandërprerë me energji elektrike duhet të arrihet në periudhën afatmesme.

“Autoritetet Shqiptare kanë si qëllim mobilizimin e shpejtë të fondeve të huaja për të financuar projekte të mëdha infrastrukturore në 2008, të cilat mund të shtojnë presionet nga ana e kërkesës dhe rreziqet fiskale. Prandaj, është e rëndësishme për t’u siguruar që defiçiti buxhetor të mos krijojë presione inflacioniste. Një defiçit prej afro 5 përqind e GDP-së (krahasuar me 4 përqind të parashikuar në 2007) do të lejonte një përshpejtim të përkohshëm të shpenzimeve të rëndësishme në infrastrukturën e transportit, duke mbajtur stabilitetin makroekonomik, duke mbrojtur konsolidimin e vazhdueshëm fiskal dhe duke dhënë financimet e mjaftueshme për investimet e tjera publike të planifikuara në periudhën afatmesme. Duke parë përpara, ne përgëzojmë qëllimin e autoriteteve për të konsideruar përfshirjen e rregullave të tjera fiskale për buxhetin e vitit 2009, në mënyrë që të ankorohen qëndrueshmërisht politikat fiskale dhe si rrjedhim të lehtësohet planifikimi i buxhetit për periudhën afatmesme.

“Politika monetare, e cila ka qënë e mirë-menaxhuar në një klimë sfiduese që sa vjen e rritet, duhet të mbetet politika kryesore kundër kërcënimeve afat-shkurtra ndaj stabilitetit të çmimit, por ankorimi i pritshmërive inflacioniste kërkon gjithashtu që aktorë të tjerë të luajnë rolin e tyre. Thatësira, kriza energjitike dhe rritja e madhe e kredisë, të gjitha këto kanë kontribuar si presione rritëse mbi çmimet. Ndërkohë, sufiçiti fiskal që rezultoi gjatë pjesës më të madhe të 2007 ka ndihmuar të balancojë këto presione, dukë i dhënë mundësinë Bankës së Shqipërisë të fokusohet për të luftuar pasojat e raundit të dytë të presioneve kosto-ngritëse inflacioniste. Duke parë përpara, në jemi te bindur se inflacioni do të rikthehet në nivelin e synuar 2-4 përqind në 2008, i mbështetur nga një politikë e duhur monetare dhe fiskale, masa në sektorin e energjisë elektrike, si dhe hapa të mëtejshëm për të përforcuar mbikqyrjen bankare. Ne mbështesim përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të rritur mbrojtjen e stabilitetit financiar, përfshirë këtu krijimin e një Memorandumi Mirëkuptimi me drejtorët e bankave të huaja në vendet e origjinës me degë përfaqësuese në Shqipëri, si dhe masa për të përmirësuar aftësinë e bankave për të ekzekutuar kolateralin.

“Progresi i reformave strukturore vazhdon. Hapat për të zgjeruar më tej bazën e tatueshme, së bashku me masa të tjera kompensimi të të ardhurave, do të lejojë qeverinë të ulë në mënyrë të qëndrueshme nivelin e tatimit mbi të ardhurat e kompanive; kjo, së bashku me përmirësimet e planifikuara në regjistrin e tatimpaguesve dhe administratës së sigurimeve shoqërore, do të ndihmojë në uljen e informalitetit në ekonomi, e cila nga ana tjetër, do të lejojë ekonominë të vjelë përfitimet nga zhvillimi i mëtejshëm i tregut financiar në të ardhmen. Për sa i përket menaxhimit të borxhit, ne mirëpresim tej-zgjatjen kohore të maturiteteve të borxhit të brendshëm të qeverisë dhe mbështesim përpjekjet e autoriteteve për të zgjeruar tregun vendas të parasë dhe bonove. Megjithëse ka progres deri më sot në fushën e statistikës, lista e gjërave që duhen bërë mbetet shumë e gjatë. Për këtë arsye, dy misione të asistencës teknike të FMN-së, gjatë gjashtëmujorit që vjen do të përqëndrohen në indeksin e çmimeve të konsumit dhe në përmirësimin e llogarisë kombëtare statistikore.

“Pritet që rishikimi i katërt nën programin e përbashkët PRGF/EFF do të paraqitet përpara Bordit Ekzekutiv të FMN-së në fillim të vitit 2008.

“Misioni dëshiron të falenderojë autoritetet për bashkëpunimin e ngushtë dhe të vazhdueshëm si edhe mikëpritjen e ngrohtë.”